

Thirrje për anëtarë në Këshillin Këshillimor Shkencor të Observatorit të Mësimin të Historisë në Evropë.

Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës vendosi më 12 nëntor 2020 krijimin e Observatorit të mësimin të historisë në Evropë. Observatori i Mësimin të Historisë në Evropë synon të kryejë studime/raporte për mënyrën se si mësohet historia në Evropë, të kryejë mbledhje, konferenca dhe studime tematike që lidhen me çështje specifike në mësimin e historisë. Observatori i Mësimin të Historisë përbëhet nga dy organe: Bordi Drejtues dhe nga Këshilli Këshillimor Shkencor. Janë 17 shtete, që i janë bashkuar nismës së Këshillit të Evropës, përkatësisht: Shqipëria, Andorra, Armenia, Qipro, Franca, Gjeorgjia, Greqia, Irlanda, Luksemburgu, Malta, Portugalia, Maqedonia e Veriut, Rusia, Serbia, Sllovenia, Spanja dhe Turqia.

Këshilli i Evropës, nëpërmjet Observatorit të Mësimin të Historisë, ka shpallur thirrjen për 11 vende për anëtarë në Këshillin Këshillimor Shkencor.

Kandidatët e interesuar janë të ftuar të aplikojnë online, duke plotësuar [formularin online](#) (klikoni mbi “*formularin online*”).

Kjo thirrje u drejtohet ekspertëve të mësimin të historisë, profesionistëve si dhe pedagogëve të historisë në universitete.

Këshilli Këshillimor Shkencor përbëhet nga 11 anëtarë. Mandati i anëtarëve të këtij Këshilli fillon më datën 7 qershor 2021 dhe mbaron më datën 6 qershor 2023. Kohëzgjatja e mandatit është dyvjeçar, vetëm një herë me të drejtë rinovimi.

Ky Këshill ka funksion këshillues për të siguruar cilësinë akademike, shkencore dhe metodologjike të veprimtarive që do të kryhen, veçanërisht në përgatitjen e raporteve. Këshilli Këshillimor Shkencor drejtohet nga presidenti i tij, i cili zgjidhet nga anëtarët e tij.

Kriteret, që kandidatët duhet të përmbushin, janë:

1. Të zotërojë diplomë të studimeve të larta në shkencat shoqërore ose humane.
2. Të ketë të paktën 5 vite përvojë në mësimdhënien e historisë.
3. Të jetë i aftë për të punuar në njërin nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (anglisht ose frëngjisht).

Kritere të veçanta:

1. Eksperiencë kërkimore në histori, në mësimdhënien e historisë ose në disiplina të ngjashme përkatësisht në vendet anëtare të Observatorit (17 shtetet anëtare, të lartpërmendura).
2. Eksperiencë në mësimdhënien e historisë në nivelet e ndryshme të sistemit arsimor përkatësisht në vendet anëtare të Observatorit.
3. Eksperiencë profesionale në një mjedis multidisiplinar, e preferueshme në kontekst ndërkombëtar.

Ju bëjmë me dije se përzgjedhja e kandidatëve do të kryhet nga Bordi Drejtues i Observatorit të Mësimin të Historisë. Bordi Drejtues do të zgjedhë anëtarët e Këshillit Këshillimor Shkencor në mbledhjen e datës 7 qershor 2021.

Kandidatët jofitues do të mbeten në listën rezervë në bazë të numrit të votave të marra. Kjo listë ka vlefshmëri po aq sa kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Këshillimor Shkencor. Lista rezervë do të përdoret në rast se do të ketë vende vakante.

Kandidatët duhet të plotësojnë (klikoni mbi “*formularin e aplikimit*”) [formularin e aplikimit](#) online në anglisht ose në frëngjisht. Afati për dërgimin e kandidaturave online është deri më datë **5 prill 2021, ora 13:00** (me orën e Evropës Qendrore).

Për informacione të mëtejshme rreth Observatorit të Mësimit të Historisë, ju ftojmë të konsultoni faqen zyrtare të Këshillit të Evropës në linkun e mëposhtëm:

<https://www.coe.int/en/web/education/-/observatory-on-history-teaching-in-europe-a-new-flagship-project-of-the-education-department>